



# NE, PËRFAQËSUESIT E POPULLIT



## QYTETARËT PUNËTORË

ALBIN (14), SUAD (15), MUHARREM (14), ENDRIT (14), BLERINA (13), ZADE (14), ADNAN (14)



**Ne mendojmë se është shumë e rëndësishme të mësojmë për qytetarinë aktive. Prandaj, ne kemi vendosur që të shkruajmë pikërisht për këtë temë. Shpresojmë që ju do të mësoni shumë nga puna jonë**

Fillimisht do t'iu tregojmë se kë e quajmë qytetar. Qytetar është çdo person, i cili jeton brenda kufijve të një shteti të caktuar. Secili qytetar për t'u llogaritur qytetar i një shteti, duhet të ketë një dokument që i tregon të gjitha të dhënat e personit në fjalë. Në vazhdim të Punëtorisë, bashkë me edukatoren tonë mësuam për qytetarinë aktive.

Ne thamë se qytetar aktiv është çdo qytetar i/e cila vepron në të mirën e komunitetit të tij. Ai komunitet mund të jetë fshati, lagjja, shkolla apo qyteti i tij. Por, çfarë bën ai/ajo? Ai ose ajo voton, shpreh mendimet e tij/saj lirshëm, pastron, kandidon, proteston, marshon, bën ankesa apo kërkesa në raste të mospajtimit me ndonjë gjë. Këto ankesa dhe kërkesa i dërgon pastaj në institucionet e ndryshme, si p.sh. në komunë apo edhe në Qeveri. Ne qytetarët aktiv duhet të jemi dakord mes vete nëse dëshirojmë të arrijnë ndryshim pozitiv në lagjen, qytetin, shtetin tonë. Kjo sepse kur bashkojmë forcat tona, ne mund të arrijmë diçka akoma më të madhe. Ne, po ashtu zbatojmë rregullat dhe ligjet. Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat e përmirësojnë jetën tonë. Qytetarët aktiv kanë për detyrë të mbajnë ambientin pastër, sepse me ambient të pastër ne do të kemi shëndet më të mirë dhe jetë më


të gjatë. Të gjithë qytetarët pa marrë parasysh racën, fenë, gjininë, etninë apo profesionin kanë të drejtat e barabarta. Këto të drejta janë: e drejta për dinjitet, e drejta e shkollimit, e drejta e votës, e drejta e punës, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e informimit, etj. Pasi që mësuam për qytetarinë aktive, ne menduam gjatë nëse edhe ne jemi qytetarë aktiv apo jo. Unë personalisht kam marrë pjesë në një organizatë joqeveritare „Save the Children“, në të cilën kemi debatuar se sa kanë të drejta fëmijët në komunën tonë. Ne, po ashtu, një pjesë të kohës e kemi kaluar duke debatuar me edukatorën për disa arsimtarë në shkollën tonë, të cilët nuk po sillen edhe aq mirë gjatë orëve të mësimit. Ata ndonjëherë nuk na trajtojnë neve sipas parimeve demokratike. E kjo sipas nesh nuk është në rregull dhe ne do të vazhdojmë të bëjmë ankesa derisa të përmirësohet gjendja në klasë. Këtë e bëjnë qytetarët aktiv!



Qytetarët aktiv të Mitrovicës

# KUVENDI I JEP NGJYRË JETËS SONË

ENDRIT (13), ERENIK (13), HALIT (13), ALBION (13), SAMIRE (13), ALTIN (13), AJNISHAH (14)



**Demokracia, ky sistem i paqes dhe i lirisë, na ka sjellur të drejtat tona, barazinë, tolerancën, respektin dhe ligjet. Por, nga vijnë ligjet? Këtë mësojeni nga ne, deputetët e vegjël**

Ligjet vijnë nga Kuvendi, institucion ky ligjvënës që e rregullon dhe e përmirëson jetën e secilit qytetar. Ky përmirësim arrihet duke u miratuar ligje efektive dhe të nevojshme. Lirinë për të miratuar ligje, Kuvendit ia ka dhënë populli, i cili ka fuqi të jashtëzakonshme. Ligjvënësit janë vetë deputetët, të cilët përgjegjësi dhe detyrë kryesore kanë jetën dhe të ardhmen e gjithë



**Vlerë që zbatohet me përpikëri në shtetet demokratike**

qytetarëve. Kjo i bie se deputetët fillimisht marrin parasysh interesat e popullit dhe kërkesat e tyre. Këto interesa dhe kërkesa shndërrohen në ligje, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë.

Në rast se ka mosrespektim të ligjeve, vihen në pah ndëshkimet. Por, populli nëse e sheh të nevojshme mund të propozoj edhe vetë projektligje. Këtë e bën duke nënshkruar peticione me mbi 10.000 nënsh-

krime. Nëse pyesim se si Kuvendi e ndikon jetën tonë, ne do t'iu tregojmë me anë të një ligji të miratuar në vitin 2001. Ligji për të cilin po flasim është ligji për mbrojtjen nga zhurma. Ky ligj thotë se zhurma duhet të shmanget, parandalohet ose zvogëlohet për shkak të efektit të dëmshëm të saj. Sipas këtij ligji, zhurmë e dëmshme për shëndetin e njeriut është çdo zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara, shikuar nga aspekti kohor dhe nga vendi ku buron zhurma, në mesin ku njerëzit punojnë dhe jetojnë. Pikërisht ligje të tilla i japin jetës sonë kuptim dhe siguri, dhe miratimi i këtyre ligjeve dëshmon punën e pa ndalshme që Kuvendi e bën për ne.


Andaj, mesazhi ynë për të gjithë është: bëni zgjedhjen e duhur. Zgjedhja juaj e ndikon jetën time dhe jetën tuaj. Ndërsa, zgjedhja jonë do të ndikojë të ardhmen dhe jetën e shumë njerëzve të tjerë. Të bashkëpunojmë për një të tashme dhe një të ardhme më të mirë, më të ndriçuar dhe me të sigurt për të gjithë. Jepni arsye mënyrës së jetesës suaj. Ju mundeni!



**Ligjet duhet të zbatohen nga të gjithë**

## PËFAQËSUESIT ZGJEDHEN NGA POPULLI

ALBION (14), DIAMANT (14), LEONORA (13), MRIZA (12), ALLMA (14), AMELL (14), EDMOND (14),  
ALTIN (13)



Jo të gjithë qytetarët i kanë nevojat dhe kërkesat e njëjta

### Të dashur lexues, nga titulli i temës mund të paramendoni se i tërë diskutimi ynë në grup të vogël ishte rreth zgjedhjeve dhe partive politike

Sot ne, anëtarët e grupit tonë kemi zhvilluar diskutime për zgjedhjet dhe partitë politike, qëllimin e tyre, si dhe rëndësinë që kanë këto të dyja në jetën tonë. Mënyra se si në nxënësit e këtij grupi kemi bërë ndërlidhjen mes këtyre temave, besojmë dhe shpresojmë që do t'iu pëlqej edhe juve, shumë të dashur lexues. Demokracia është sistem i qeverisjes, në të cilin qytetarët janë ata të cilët fuqinë e tyre e bartin tek personat që kandidojnë në zgjedhje. Këta persona pasi të marrin votat ndryshe njihen si përfaqësues të popullit.

Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare, janë ata të cilët përmes votës së lirë i zgjedhin përfaqësuesit e vet. Këta përfaqësues mund të jenë edhe të pavarur, pra nuk iu përkasin ndonjë partie politike.

Ne besojmë që keni pasur rastin të dëgjoni se edhe në Kuvendin e Kosovës ka deputetë të pavarur. Mirëpo, shumica prej deputetëve të cilët janë në Kuvendin e Kosovës, iu përkasin partive të ndryshme politike. Pra, në Kuvend ka diversitet të partive politike, ashtu siç ka edhe diversitet të etnive. Kur jemi tek deputetët, mendojmë që është e drejtë t'iu tregojmë se ata zgjedhen në zgjedhjet parlamentare apo ndryshe që njihen si zgjedhjet qendrore. Njësoj si deputetët edhe kandidatët për Kryetar të Komunës apo edhe për

asamble komunale mund të jenë kandidat të pavarur. Sipas nesh, përfaqësuesit nuk është e domosdoshme të jenë pjesë e ndonjë partie politike për ta fituar besimin e qytetarëve. Mjafton punë dhe përkushtim maksimal për ta arritur këtë gjë. Pasi që i kemi përmendur zgjedhjet parlamentare, duhet të tregojmë pak edhe për zgjedhjet lokale apo ndryshe komunale. Në këto lloje të zgjedhjeve, prapë janë qytetarët ata të cilët votojnë për kandidatët për kryetar të komunës dhe kandidatët për asamble komunale.

Pra, vota e qytetarëve iu jep fuqi dhe pushtet përfaqësuesve që të veprojnë dhe të marrin vendime për të mirën e qytetarëve, pa dyshim. Vullneti dhe puna aktive e qytetarëve, çdo herë ka sjellur rezultate të kënaqshme. E rezultate të këtij lloji, treguam edhe ne sot me punën tonë, e cila vazhdon edhe në artikullin tjetër.



Të jemi gazetarë-mundësia më e mirë që kishim deri më sot

**Ne iu paralajmëruam në fillim të artikullit të kaluar që grupi ynë kishte dy tema diskutimi. Në artikullin e parë, jeni njoftuar më shumë për zgjedhjet, kurse tash do të njoftoheni për partitë politike. Në këtë faqe, ka edhe disa vizatime të anëtarëve të grupeve të tjera. Shpresojmë t’iu pëlqejnë dhe të kënaqeni gjatë leximit të tyre**

Kosova si vendi më i ri në Evropë, është po ashtu edhe një ndër vendet ku demokracia dhe diversiteti politik zënë një vend shumë të rëndësishëm. Thënë më mirë, falë demokracisë që e kemi, Kosova ka diversitet politik. Me diversitet politik mendojmë që në vendin tonë numri i partive politike është shumë i madh dhe qytetarët kanë mundësi që të bëjnë zgjedhjen e duhur kur është puna për t’i zgjedhur përfaqësuesit e tyre.

Sa më shumë opsione që kemi aq më e mirë bëhet zgjedhja bëhet më e mirë. Padyshim që është më e vështirë, sepse kërkon shumë përkushtim të vlerësojmë drejtë.

Pasi që temat tona kishin të bënin më shumë me partitë politike, ne vendosëm të flasim më shumë në këtë drejtim. Partitë politike janë grupe të qytetarëve, të cilët kanë ide dhe interesa afërsisht të njëjta, qëllimi i

të cilave vënia në funksion e këtyre ideve.

Çdo parti politike ka për synim rritjen e anëtarëve të saj. Ne jemi dëshmitarë edhe në vendin tonë, ku gjatë kohës së zgjedhjeve dëgjojmë shumë familjarët tonë duke i përmendur pa rreshtur partitë e ndryshme politike.

Diamanti, shoku ynë, tregoi një rast kur një familjar i tij pasi që kishte kandiduar për asamble në Komunën e Mitrovicës, ka kërkuar nga shoqëria dhe rrethi i tij mbështetje. Që të mos keqkuptohet, ai nuk e ka kërkuar votën e tyre, mirëpo disa këshilla rreth disa tubimeve publike që kishte për t’i mbajtur me qytetarët, sepse sipas tij kjo do t’i ndihmonte. E sot, personi për të cilën po flasim është pjesë e Asamblesë Komunaletë Mitrovicës dhe është duke bërë punë të mrekullueshme.




**Leonora, anëtare e grupit e cila kontribuoi shumë për këtë artikull. Këtu ajo është duke shkruajtur se si do të duhej të ishte një parti ideale**




**Një parti politike ideale sipas Leonorës është ajo e cila brenda strukturave të saj ka barazi gjinore, e jo vetëm partia e cila mbizotrohet nga qytetarët e gjinisë mashkullore**



**Është shumë e rëndësishme, po ashtu, që edhe personat me nevoja të veçanta të jenë pjesë e partive politike**



**Partitë politike të përbëra nga deputetët punojnë në Kuvend, institucionin e vetëm legjislativ**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Bedri Gjinaj“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1 & VIII-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Mitrovicë

